



Prishtinë, 22.04.2026
Kodi i ZRRE-së: V_3152_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2911_02_26** i datës 16.02.2026;
- Ankesa e konsumatorit e dt. 16.03.2026.

në seancën e mbajtur më datë **22.04.2026** nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **F. R.**, nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2911_02_26 i datës 16.02.2026.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 16.02.2026 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2911_02_26 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit F. R., me shifër 003565, lidhur me kontestimin e faturimit me matje për sezonën ngrohëse 2024/25, dhe në fuqi ka mbetur Përgjigja e NQ Termokos – Divizioni për Konsumatorë e dt. 26.03.2025.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori F. R., brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Pas instalimit të matësve, kam vërejtur parregullsi serioze në mënyrën e regjistrimit të konsumit të energjisë termike.
- Përgjatë shqyrtimit të ankesës time, nga shkalla e parë nuk është bërë një verifikim i plotë dhe i pavarur teknik i funksionimit të matësve dhe mënyrës së faturimit.
- Kërkon rishqyrtimin e vendimit për refuzim të ankesës, të urdhërohet një kontroll dhe ekspertizë teknike e pavarur për matësit e vendosur në radiatorët e banesës dhe të verifikohet mënyra e regjistrimit të impulseve të konsumit, në radiatorët që kanë qenë të ndalur.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2026 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit të dt. 16.03.2026; Vendimin e DMK-së të dt. 16.02.2026, Ankesën e konsumatorit në DMK e dt. 08.08.2025, Përgjigjen e NQ Termokos, Faturat e kontestuara, Kartelën e konsumatorit me shifër 003565; të dhënat nga leximi dhe faturimi për gjithë sezonën ngrohëse 2024/25; si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, vihet re që, konsumatori për sezonën ngrohëse 2024/25, duke filluar nga muaji 10-11/2024 e deri më 01-04/2025 është faturuar me matje ose me tarifën C11, ndërkaq për muajin 12/2025 konsumatori është faturuar me sipërfaqe ngrohëse ose pa matje (C33). Bordi i ka analizuar me kujdes faturat e kontestuara dhe ka gjetur se, si të tilla janë të sakta dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në pikën matëse të konsumatorit, dhe se konsumatori është faturuar sipas gjendjeve të regjistruara në sistemin matës të tij. Më tej, janë analizuar edhe të dhënat lidhur me impulset e gjeneruara për periudhën që konsumatori është faturuar me matje dhe ka gjetur se – për gjashtë (6) radiatorët, me matës të vendosur me numra serik si në shkresat e lëndës, me saktësi është regjistruar numri i impulseve ose sasia e energjisë termike që konsumatori e ka shpenzuar dhe rrjedhimisht, është faturuar sipas gjendjeve të regjistruara në sistemin matës, ashtu që, për impulset e gjeneruara në sistem ose shpenzimi i konsumatorit është si në vijim: muaji 10/2024 = **417 impulse**, muaji 11/2024 = **1,852 impulse**, muaji 01/2025 = **2,234 impulse**, muaji 02/2025 = **2,408 impulse**, muaji 03/2025 = **1,359 impulse** dhe muaji 04/2025 = **996 impulse**. Pra, nga sa mund të shihet, shpenzimi i konsumatorit varion nga muaji në muaj, dhe sikur të kishte matje të pasaktë, edhe shtrirja e konsumit do të ishte e njëtrajtshme ose e pandryshueshme, çka në rastin konkret nuk qëndron. Andaj, edhe pretendimet e konsumatorit për faturim paushallë ose jo të saktë, nuk janë të bazuara.

Ndërlidhur me çështjet e ngritura si mënyra e përlogaritjes së faturës, Bordi thekson se, në të gjitha faturat e konsumatorit, është pasqyruar me saktësi numri i impulseve të regjistruara dhe të faturuara, përfshirë këtu tarifatat për energjinë termike, si dhe komponentët e tjera të tarifave si konsumi i përbashkët dhe kapaciteti termik. Për më tepër, vendimet për përcaktimin e tarifave të energjisë termike, për çdo sezonë ngrohëse janë publike, dhe proceset e shqyrtimeve tarifore u nënshtrohen proceseve të konsultimit publik, ku konsumatori, dhe çdo palë tjetër e interesuar, mund të ofroj kontributin e tij përmes dërgimit të komenteve në raportet konsultative përkatëse.

Duke iu referuar edhe nenit 30 – Pajisjet matëse, të Ligjit për Energjinë Termike, është e përcaktuar si në vijim: “1. **Furnizimi me energji termike matet me pajisje matëse** ndërsa, instalimi, operimi, mirëmbajtja apo zëvendësimi i pajisjeve për matje, bëhet në pajtim me Kodin e Matjes. 2. Energjia termike e shfrytëzuar nga konsumatori llogaritet me pajisje për matje që është pronë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 3. Tek konsumatorët fundor individual -objekte individuale të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në pikën e furnizimit, sa më afër kufirit të pronës së konsumatorit. 4. Tek konsumatorët fundor në ndërtesa kolektive - objekte kolektive të banimit dhe komerciale - pajisjet për matje duhet të vendosen në hapësirat e secilit konsumatorë, nëse është teknikisht e mundshme dhe leximi duhet të bëhet pa pasur qasje në hapësirat e banimit të



konsumatorit. 5. Kufiri i pronës, përgjegjësia për objektet termike, vendi për vendosjen e pajisjeve matëse dhe të gjitha aspektet tjera të matjes përcaktohen me Kodin e Matjes”. Pra, faturimi me matje është kërkesë ligjore, e për më tepër, edhe projekti i vendosjes së matësve e ka këtë qëllim, që konsumatorët të kursejnë dhe të shfrytëzojnë energjinë termike në mënyrë racionale dhe rrjedhimisht, të paguajnë aq sa shpenzojnë.

Duke u bazuar në nenin 28 – Faturimi, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, si në vijim: *“Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”*, Bordi thekson se, NQ Termokos, ka vepruar në harmoni me kërkesat ligjore që burojnë nga legjislacioni sekondar.

Po ashtu, duke u bazuar në nenin 6 – Furnizimi me Energji termike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *“të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë termike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë termike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i pati në konsideratë edhe disa prova të tjera materiale si në shkresat e lëndës, por që të njëjtat nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast. Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova konkrete.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmimeve dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti Faturave të kontestuara, të dhënave të pranuar nga NQ Termokos, si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO;
- Konsumatorit **F. R.**,
- Arkivit të ZRrE-së